



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 2755 /2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12, 40, Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 08/L-066 për vitin 2022, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048 neni 27, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datën 28.04.2022 merr këtë:

V E N D I M

**PËR BARTJEN E MJETEVE TË PASHPENZUARA TË TË HYRAVE VETANAKE
KOMUNALE NGA VITI 2020 DHE 2021 NË VITIN 2022**

1. Kuvendi i komunës miratoi për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake komunale të vitit 2020 dhe 2021 në vitin 2022.
2. Të hyrat e bartura nga viti 2020 në vitin 2021 kanë qenë në shumën prej 57,779.88 €, prej tyre janë shpenzuar në shumën prej 57,001.74 €, kurse për bartje kanë mbetur edhe 778.14€. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2021 kanë qenë në shumë prej 325,140.79 €, prej tyre janë të shpenzuara 253,181.28 €. Pra në total, të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit 2020 dhe 2021 janë në shumën prej 72,737.76 €, të cilat i bartim për vitin 2022.
3. Këto mjete sipas pikës 2 (në shumë prej 72,737.76 €, i shpërndajmë nëpër këto kategori ekonomike të shpenzimeve, si vijon:
 - mallra dhe shërbime në shumë prej 21,800.00 €,
 - subvencione dhe transfere në shumë prej 7,000.00 € dhe
 - shpenzime kapitale në shumë prej 43,937.76 €.
4. Në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime në shumë prej 21,800.00 €, në nën-programet si vijon:
 - Administrata (16335), kodi funksional (0133), shuma prej 2,500.00 €,
 - Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480), kodi funksional (0620), në shume prej 17,000.00 €
 - Shërbimet e shëndetësisë primare (75050), kodi funksional (0721) shuma prej 1,000.00 €,
 - Administrata e arsimit (92175), kodi funksional (0980), shuma prej 1,000.00 €,
 - Arsimi i mesëm (95220), kodi funksional (0922), shuma prej 300.00 €.
5. Në kategorinë ekonomike Subvencione dhe transfere në shumë prej 7,000.00 €, në nën-programin, si vijon:
Zyra e kryetarit (16035), kodi funksional (0111) shuma prej 7,000.00 €.

6. Në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale në shumë prej 43,937.76 € në nën-programet dhe në projektet, si vijon:

Planifikimi urban dhe inspeksioni (66480), në projektet:

“Gjelbërimi i disa hapësirave publike”, kodi (41640) shuma prej 18,000.00 €.

“Rregullimi i parkut në rrugën "Isa Berisha" (asfaltim, trotuar, ndriçim public, gjelbërim), kodi (51085) shuma prej 22,437.76 €.

Shërbimet e shëndetësisë primare (75050) në projektin :

“Rregullimi i infrastrukture ne QKMF” (Rregullimi i nxemjes), kodi (51024) shuma prej 3,500.00 €

7. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Financave - Departamenti i Buxhetit,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data : 28.04.2022





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.2819 /2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11 , 17 shkronja (r), 40.2, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 neni 2.3, Statutin e Komunës neni 63, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2022 merr:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR “JAVËN KULTURORE” 2022

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për “Javën Kulturore” 2022 në Komunën e Hanit të Elezit.
2. Duke ju referuar Nenit (1) të këtij vendimi i cila i dedikohet “Javës Kulturore” 2022, mjetet financiare do të merren nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime nga Drejtoria për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport dhe nga Zyra e Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit. Vlera e përgjithshme e mjeteve financiare për mbështetje të “Javës Kulturore” 2022 është 4968.25 €.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Zyra e Prokurimit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 28.04.2022

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.2659/2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 64, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2022 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR-MARS 2022

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin financiar për periudhën Janar - Mars 2022.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i financiar për periudhën Janar-Mars 2022 i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Buxheti i miratuar për vitin fiskal 2022 është në shumë prej 2,759,758.00 €, në kategorinë paga dhe mëditje shpenzimi është në shumë prej 373,751.07 € apo 21.28 %, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 28,039.46 € apo 7.26%, në kategorinë ekonomike shërbime komunale shpenzimi është në shumë prej 11,970.72 € apo 17.68 %, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 0.00 €, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale kemi shpenzuar 0.00 € dhe në rezervat 0.00 €. Totali i shpenzimit për periudhën Janar -Mars të vitit 2022 është në shumë prej 413,761.25 € apo 15%. Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsejtë 65,244.90 € të hyra vetanake për periudhën janar-mars 2022 apo 17.11% e planit të të hyrave vetanake, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2021 kemi një rritje më shumë për 11,176.42 € apo 20,67 %.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 28.04.2022





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 3022 /2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 40.2, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit me numër 01/Nr.7703/2018 neni 79, 80, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2022 merr:

VENDIM

**PËR PLOTSIM NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR KUSHTET, KRITERET DHE
PROCEDURAT E NDARJES SË SUBVENCIONEVE**

1. Me këtë vendim aprovohet plotësim ndryshimi i rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.
2. Plotësim ndryshimi i rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve lëshohet në procedurë të diskutimit publik me qytetarët.
3. Obligohet Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport t'i zhvilloj procedurat e diskutimit publik me qytetarët dhe ekzekutivin e komunës dhe pas kësaj rezultatet e diskutimit publik t'i paraqet në Kuvendin e Komunës për finalizimin e plotësim ndryshimit të rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plotësim ndryshimi i rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me numër 01/Nr. 2821/2022.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet përkatëse),
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 28.04.2022

